

NOA SH.A.

**PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019
(ME RAPORTIN E AUDITUESIT TE PAVARUR)**

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Flukseve të Parasë	3
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	4
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM	5
2. BAZAT KONTABËL DHE PËRGATITJA E PASQYRAVE FINANCIARE	5
3. MONEDHA FUNKSIONALE DHE RAPORTUESE	5
4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL	6
5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL	8
6. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR.....	21
(a) Struktura e administrimit të rrezikut	21
(b) Rreziku i kredisë	21
(c) Rreziku i likuiditetit	27
(c) Rreziku I likuiditetit (vazhdim)	28
(d) Rreziku i tregut.....	28
(d) Rreziku i tregut (vazhdim)	29
(e) Rreziku operacional	33
(f) Administrimi i kapitalit..	34
(g) Informacion shtesë mbi fluksin e parasë.....	34
7. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE	35
8. TË ARDHURAT NGA INTERESAT	39
9. SHPENZIME PËR INTERESA	39
10. TARIFA DHE KOMISIONE, NETO	39
11. HUMBJA NGA PROVIZIONI I HUAVE DHE PARADHËNIE VETË Klientëve ..	39
12. TË ARDHURA TË TJERA	40
13. SHPENZIME PERSONELI.....	40
14. SHPENZIME TË TJERA	40
15. TATIMI MBI FITIMIN	41
15. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM).....	42
16. MJETET MONETARE DHE EKUIVALENTET ME TO	42
17. HUA INSTITUCIONEVE FINANCIARE	42
18. HUA DHE PARADHËNIE Klientëve, NETO	43
19. AKTIVE TË QËNDRUESHME TË TRUPËZUARA DHE AKTIV ME TË DREJTË PËRDORIMI.....	46
20. AKTIVE TË QËNDRUESHME TË PATRUPËZUARA	47
21. AKTIVE TË TJERA	48
22. HUA	48
23. OBLIGACIONE	49
24. GRANTE	49
25. DETYRIME TË TJERA	49
26. KAPITALI I PAGUAR.....	50
27. REZERVA LIGJORE	50
28. PALËT E LIDHURA	50
29. ANALIZA E MATURITETIT TË AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE	51
30. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KONSTATUARA	52
31. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT	52

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PËR AKSIONARËT E NOA SHA

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të NOA sh.a (më poshtë "Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2019, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur të NOA sh.a jepin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019, si dhe të rezultatit financiar dhe fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragafin *Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël ("Kodi i BSNEKP") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri ("Kodi IEKA") dhe kemi përbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodi i BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen në Shënimin 31 Ngjarjet Pas Periudhes së Raportimit në pasqyrat financiare ku shpaloset ngjarja e rëndësishme jo rregulluese që lidhet me pandeminë e koronavirusit (COVID-19) dhe vlerësimin e drejtimit për ndikimin e saj në Shoqëri. Ndërprera e aktivitetit normal ekonomik në Shqipëri që vjen nga COVID-19 mund të ndikojë negativisht në Shoqëri për sa i përket përfitimit, likuiditetit dhe aftësisë së tij për të përbushur kushtet e huave dhe kërkesat e kapitalit. Për shkak të dinamikës së paparashikueshme të COVID-19, nuk është i praktikueshëm sigurimi i një vlerësimi të besueshëm i efekteve të mundshme të pandemisë. Opinionin ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Informacione të tjera të përfshira në Raportin Vjetor 2019 të NOA

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të NOA-s për vitin 2019 të përgatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" përvëç pasqyrave financiare dhe këtij reporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Degës për vitin 2019 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij reporti të audituesit.

Opionioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbolon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identikuara më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe te vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e Drejimit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të dhe për ato kontolle të brendshme, që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përvëç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përvëç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar në qeverisjen e Shoqërisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtimit ose gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencia auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të térheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqeria të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbarjtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e NOA sh.a, përvëç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojme gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

Ernst & Young Ent. fid. sh.p.r.s.
2 korrik, 2020
Tiranë, Shqipëri

Mario Vangjel
Auditues Ligjor



NOA SH.A.

Pasqyra e Pozicionit Financiar

(Shumat në mijë lekë)

	Shënimë	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Aktivet			
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	16	327,691	229,028
Hua institucioneve financiare	17	540,659	52,794
Hua dhe paradhënie klientëve, neto	18	4,705,878	4,399,623
Inventari dhe aktive të tjera	21	27,881	35,201
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara			
dhe aktive me të drejtë përdorimi	19	166,320	31,242
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	20	6,041	9,836
Aktive të shtyra tatimore	15	25,716	27,362
Totali i aktiveve		5,800,186	4,785,086
Detyrimet dhe kapitali			
Detyrimet			
Grante	24	-	230
Tatim fitimi i pagueshëm	15	11,096	13,540
Detyrime të tjera	25	188,487	80,405
Obligacione të emetuara	23	81,867	81,867
Hua	22	4,244,596	3,543,353
Totali i detyrimeve		4,526,045	3,719,395
Kapitali			
Kapitali i paguar	26	731,838	731,839
Rezerva ligjore	27	36,351	27,581
Fitime të mbartura		505,952	306,271
Totali i kapitalit		1,274,141	1,065,691
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		5,800,186	4,785,086

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitur nga faqja drejtimi 5 deri në faqen 53 dhe që janë pjesë përbërëse e Pasqyrave Financiare.

NOA SH.A.

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse

(Shumat në mijë lekë)

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor

	Shënime	2019	2018
Të ardhura nga interesat	8	1,133,826	974,336
Shpenzime për interesa	9	(276,027)	(264,437)
Të ardhura neto nga interesat		857,799	709,899
Të ardhura nga tarifa dhe komisione	10	63,271	13,595
Shpenzime për tarifa dhe komisione	10	(2,011)	(2,590)
Tarifa dhe komisione neto		61,260	11,005
Fitimi neto nga rimarrja e kredive dhe paradhëni e klientëve	11.2	134,235	152,421
Të ardhura nga shitja e portofolit të kredive të humbura	11.3	-	45,240
Të ardhura të tjera	12	5,991	6,125
Të ardhura operative neto		1,059,285	924,690
Shpenzime personeli	13	(351,800)	(314,578)
Shpenzime operative të tjera	14	(170,829)	(207,333)
Humbje nga provizioni i huave dhe paradhënieve për klientët	11.1	(148,159)	(163,941)
Shpenzime zhvlerësimi	19	(54,114)	(15,693)
Shpenzime amortizimi	20	(9,238)	(10,707)
Humbja neto nga kursi i këmbimit		445	(2,314)
Shpenzime totale operative		(733,695)	(714,566)
Fitimi para tatimit		325,590	210,124
Tatimi mbi fitimin	15	(51,275)	(34,729)
Fitimi për vitin		274,315	175,395
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		274,315	175,395

Pasqyra e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura nga faqja drejtimi 5 deri në faqen 53 dhe që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

NOA SH.A.

Pasqyra e Flukseve të Parasë

	Shënimë	2019	2018
Flukset e parasë nga aktivitetet operative:			
Fitimi për vitin para taksës nga vazhdimësia operative		325,590	210,124
<i>Rregullimet për:</i>			
Shpenzime zhvlerësimi	19	54,115	15,693
Shpenzimi financiar i aktiveve me të drejtë përdorimi		6,486	-
Shpenzime amortizimi	20	9,238	10,707
Humbje nga nxjerra nga përdorimi i aktiveve		88	261
Humbje nga zhvlerësimi i kredive ndaj klientëve	11.1	148,159	163,941
Humbjet neto nga kursi i këmbimit		(43,388)	(169,748)
Amortizimi i granteve	24	(230)	(2,767)
Të ardhura nga interesa	8	(1,133,826)	(974,336)
Shpenzime për interesa	9	269,529	264,437
<i>Ndryshime në</i>			
Hua dhe paradhënie klientëve		(441,132)	(641,716)
Hua institucioneve financiare		(484,077)	(12,130)
Aktive të tjera		7,319	(3,513)
Detyrime të tjera		(18,576)	9,236
		(1,300,705)	(1,129,811)
Interes i arkëtar		1,120,927	969,126
Interes i paguar		(273,456)	(267,106)
Tatimi mbi fitimin i paguar		(52,072)	(27,988)
Mjetet monetare (të përdorura) /gjeneruar nga aktiviteti operativ, neto		(505,306)	(455,779)
Flukset e parasë nga aktivitete investuese:			
Blerje të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	19	(23,810)	(19,856)
Blerje të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara	20	(5,442)	-
Mjete monetare të përdorura në aktivitetet investuese, neto		(29,252)	(19,856)
Flukset e Parasë nga aktivitete financuese:			
Hyrje nga huatë	6f	2,628,113	2,062,978
Pagesa nga huatë	6f	(1,881,520)	(1,558,851)
Ripagimet e detyrimeve të qirasë		(44,279)	-
Dividendë të paguar	26	(65,865)	(69,890)
Mjete monetare të gjeneruara/(përdorura) nga aktiviteti financuese, neto		636,449	434,237
Rritje /(Rënje) te mjeteve monetare dhe ekuivalente me to, neto		101,891	(41,398)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	16	229,028	272,646
Diferencë neto nga kursi i këmbimit		(3,228)	(2,220)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	16	327,691	229,028

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura nga faqja drejtimi 5 deri në faqen 53 dhe që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

NOA SH.A.

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

(Shumat në mijë lekë)

Gjendja më 1 Janar 2018

Fitimi për vitin

Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse

Transaksione me pronarët e Shoqërisë

Transferim i fitimit të mbartur në rezervën ligjore

Dividendë (shënim 27)

Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë

Gjendja më 31 Dhjetor 2018

Fitimi për vitin

Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse

Transaksione me pronarët e Shoqërisë

Transferim i fitimit të mbartur në rezervën ligjore

Dividendë (shënim 27)

Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë

Gjendja më 31 Dhjetor 2019

Kapitali Aksionar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Mbartura	Total
731,839	20,207	208,140	960,186
-	-	175,395	175,395
-	-	-	-
-	-	175,395	175,395
	7,374	(7,374)	-
		(69,890)	(69,890)
-	7,374	(77,264)	(69,890)
731,839	27,581	306,271	1,065,691
-	-	274,315	274,315
-	-	-	-
-	-	274,315	274,315
	8,770	(8,770)	-
-	-	(65,865)	(65,865)
-	8,770	(74,635)	(65,865)
731,839	36,351	505,951	1,274,141

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura nga faqja 5 deri në faqen 53 dhe që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Drejtimi i Shoqërisë ka autorizuar këto pasqyra financiare më 29 Qershor 2020 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:




Ariola Çela
Drejtor i Financës

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 *(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)*

1. Informacion i përgjithshëm

NOA SH.A (referuar si “NOA” ose “Shoqëria”), është një Shoqëri aksionare shqiptare e vendosur në Tiranë, e cila vepron në fushën e mikro-kredisë për individë dhe Shoqëri të vogla dhe të mesme. Ka filluar aktivitetin e saj në 1999 si PSHM (Partneri Shqiptar në Mikrokredi) dhe më vonë si Opportunity Albania, në 2010 aksionet e Shoqërisë u blenë nga NOA Holdings N.V, një entitet i huaj i themeluar në Hollandë. Në 2011 emri i shoqërisë u ndryshua nga Opportunity Albania në NOA SH.A. Në mars të vitit 2018 shoqëria kontrolluese përfundimtare është Amryta Capital LLP me bazë në Londër.

Në 31 dhjetor 2018, struktura e aksionarëve të NOA SH.A. është si më poshtë:

- NOA Holding N.V. 99.99%
- NOA Cooperatief U.A. 0.01%

NOA SH.A. udhëhiqet nga Këshilli i Administrimit dhe Drejtimi Ekzekutiv i Shoqërisë. Këshilli i Administrimit përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilat 4 janë të pavarur dhe nuk janë të lidhur me interesat dhe aktivitetin e Shoqërisë.

Anëtarë të Këshillit te Administrimit në datën e raportimit janë:

1. Andrew Walsh, Kryetari i Këshillit
2. Herjola Spahiu, Zv / Kryetar
3. Tomas Hlavac, Anëtar
4. Elona Gjika, Anëtar
5. Petr Sastinsky, Anëtar

Drejtimi Ekzekutiv përbëhet nga Administratorët e Shoqërisë dhe Grupi i Drejtuesve kryesorë.

Më 31 dhjetor 2019, Shoqëria operon në 25 pika shitje (2018: 26) të vendosura në të gjithë vendin duke ofruar shërbimet e saj përmes 263 punonjësve (2018: 272 punonjës). Zyrat qëndrore të NOA janë në Tiranë Shqipëri, të regjistruara në adresën “Ruga Tish Daia”, pranë Komunës së Parisit, “Kompleksi Haxhiu” (Kika 2), Pallati nr. 2, Kati 1, Tiranë.

2. Bazat kontabël dhe përgatitja e pasqyrave financiare

2.1 Bazat kontabël

Këto Pasqyra Financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Ky është seti i parë i pasqyrave financiare vjetore në te cilën është aplikuar SNRF 16 “Qiratë”. Ndryshimet e rëndësishme në politikat e kontabilitetit paraqiten në shënimin 4.

Detajet e politikave kontabël të Shoqërisë janë të përfshira në Shënimin 5.

2.2 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike.

3. Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare paraqiten në Lek Shqiptar (“LEK”), e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë. Të gjitha shifrat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, përvèçse kur shprehet ndryshe.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 *(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)*

4. Politika të rëndësishme kontabël

Në këto pasqyra financiare Shoqëria ka aplikuar për herë të parë kërkesat e SNRF 16 “Qiratë”. Natyra dhe efektet e ndryshimit si rezultati i përdorimit te këtij Standardi të ri janë përshkruar në notën 4 A më poshtë.

Disa ndryshime dhe interpretime aplikohen për herë të parë në vitin 2019, por nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Perveçse ndryshimeve më poshtë Shoqëria ka zbatuar vazhdimisht politikat e kontabilitetit siç përcaktohet në Shënimin 5 për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

Ndikimi i zbatimit të këtyre Standardeve është i kufizuar në SNRF 16 dhe kryesisht i atribuohet si me poshtë.

A. SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 zëvendëson SNK 17 Qiradhënet dhe interpretimet e lidhura. Standardi përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe dhëni e informacioneve shpjeguese të qirave dhe kërkon që qiramarrësit të njohin shumicën e qirave në pasqyrën e pozicionit finanziar. Shoqëria aplikoi SNRF 16 duke përdorur metodën retrospektive të modifikuar në datën e aplikimit filletar më 1 Janar 2019. Sipas kësaj metode Standardi aplikohet në mënyrë retrospektive me efektin kumulativ ne fillim të aplikimit të Standardit të njohur në datën e aplikimit filletar. Shoqëria ka zgjedhur të përdorë qëllimin praktik të tranzpcionit për të mos rivlerësuar nëse një kontratë është apo përmban një qira më 1 Janar 2019. Në vend të saj Shoqëria ka aplikuar Standardin vetëm për kontrata të cilat janë identifikuar më parë si qira duke aplikuar SNK 17 dhe KIRFN 4 në datën e aplikimit filletar.

Shoqëria ka kontrata me qira për degët e saj të biznesit, agjencitë dhe disa automjete. Me 31 Dhjetor 2019, Shoqëria kishte 32 kontrata qiraje, nga të cilat 30 janë qira të pasurive të patundshme përfshijnë degë (14) dhe degë agjencish (16); dhe 2 kontrata të qiradhënieve së automjeteve. Para miratimit të SNRF 16, Shoqëria e klasifikoi se cilën prej qirave të saj (si qiramarrëse) në datën e fillimit si qiratë operative. Pas miratimit të SNRF 16, Shoqëria aplikoi, një qasje të vetme njohjeje dhe matjeje për të gjitha qiradhënet, përvèç qirave afatshkurtra dhe qirave të aktiveve me vlerë të vogël. Standardi sjell kërkesa specifike dhe praktike të tranzpcionit, të cilat janë aplikuar nga Shoqëria.

Qiratë të kontabilizuara si Qira operative, më parë

Shoqëria njohu aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë për ato qira të klasifikuara më parë si qira operative, përvèç qirave afatshkurtra dhe aktiveve me vlerë të vogël. Aktive me të drejtë përdorimi njihen në shumë e barabartë me detyrimin e qirasë, rregulluar për çdo parapagim dhe qira pagese të përllogaritur dhe njohur më parë. Detyrimet e qirasë u njohën bazuar në vlerën aktuale të pagesave të mbeturat e qirasë, të skontuara me normën rritëse të huamarrjes në datën e aplikimit filletar. Shoqëria gjithashtu aplikoi praktikat e disponueshme në të cilën:

- Përdori një normë të vetme skontimi në një portofol të qirave me karakteristika të ngashme
- U mbështet në vlerësimin e saj nëse qiratë janë të mëdha, menjëherë përpëra datës së aplikimit filletar
- Aplikoi përjashtimet e qirave afatshkurtra në qiratë me afate maturimi të mbetur më pak se 12 muaj nga data e aplikimit filletar
- Përjashtoi kostot fillestare direkte nga matja e aktivit me të drejtë përdorimi në datën e aplikimit filletar
- Përdori parashikimet e saj në përcaktimin e afatit të qirasë nëse kontrata përbante opsione të shtyrjes apo përfundimit të qirasë.

Bazuar në sa më sipër më 1 Janar 2019:

- Aktivi me të drejtë përdorimi u njoh në vlerën 142,531 mijë Lek dhe u paraqit në pasqyrën e pozicionit finanziar në zërin “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, aktive me të drejtë përdorimi dhe aktive të qëndrueshme të pa trupëzuara”
- U njohën detyrime për qira shtesë në vlerën 142,531 mijë Lek (që përfshihen në zërin “Detyrime të tjera” Përdorimi I SNRF 16 nuk ka ndikim në rezervën e Shoqërisë).
- Përdorimi i SNRF 16 nuk ka ndikim në rezervën e Shoqërisë.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 (Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)

4. Ndryshimet në politikat kontabёl (vazhdim)

Detyrimet e qirasë nga 1 Janar 2019 duhet të barazohen me angazhimet e qirasë operative që nga 31 Dhjetor 2018, si më poshtë vijon:

Aktive	ALL	EUR	Total më 1 Janar 2019
Detyrimi i qirasë operative më 31 Dhjetor 2018	38,845	73,487	109,332
Norma mesatare rritëse e ponderuar e huamarrjes më 1 Janar 2019	5.75%	4.12%	-
Detyrimet e qirasë operative të skontuara më 1 Janar 2019	35,480	72,647	108,127
Zvogëluar:	-	-	-
Detyrimet lidhur me qiratë afatshkurtra	-	-	-
Detyrimet në lidhje me qiratë për aktive me vlerë të vogël	(2,340)	-	(2,340)
Shtuar:	-	-	-
Pagesat e qirasë që lidhen me periudhat e rinnovimit që nuk përfshihen në detyrimet e qirasë operative më 31 Dhjetor 2018	15,546	21,198	36,744
Detyrimet e qirasë më 1 Janar 2019	48,686	93,845	142,531

B. Standarde të tjera dhe ndryshime

Interpretimi i KIRFN 23 Pagartësi mbi Trajtimet e Tatimit mbi të Ardhurat

Interpretimi paraqet kontabilitetin e tatimit mbi të ardhurat kur trajtimet tatinore përfshijnë pasiguri që ndikojnë në zbatimin e SNK12 Tatimi mbi te ardhurat. Ai nuk vlen për taksat të cilat janë jashtë qëllimit të SNK 12, as nuk përfshin specifikisht kërkesat në lidhje me interesin dhe gjobat që lidhen me trajtime të pasigurta tatinore. Pas miratimit të Interpretimit, Shoqëria konsideroi nëse ka ndonjë pozicion të pasigurt tatinor. Interpretimi nuk ka ndikuar në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Ndryshime në SNRF 9: Karakteristika të parapagimit me kompensim negativ

Sipas SNRF 9, një instrument i borxhit mund të matet me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, me kusht që flukset monetare janë "vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën e mbetur të papaguar të principalit" (kriteri "SPPI") dhe instrumenti mbahet brenda modelit të duhur të biznesit për atë klasifikim. Ndryshimet në SNRF 9 sqarojnë se një aktiv financier kalon kriterin SPPI, pavarësisht nga ngjarja ose rrethana që shkakton përfundimin e parakohshëm të kontratës dhe pavarësisht se cila palë paguan ose merr kompensim të arsyeshëm përfundimin e para afatit të kontratës.

Përfundimi i parakohshëm mund të rezultojë nga një afat kontraktual ose nga një ngjarje jashtë kontrollit të palëve në kontratë, të tilla si një ndryshim në ligj ose rregullore që çon në përfundimin e hershëm të kontratës.

Kur parapagimi është bërë me vlerën aktuale të drejtë ose në një shumë që përfshin vlerën e drejtë të kostos për të përfunduar një instrument mbrojtës të lidhur, Shoqëria vlerëson flukset monetare kontraktuale specifike për instrumentet e lidhura të borxhit për të përcaktuar nëse plotësohet kriteri SPPI. Këto ndryshime nuk kishin asnjë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Interesat afatgjata në sipërmarrjet e përbashkëta – Ndryshime në SNK 28: ndryshimet sqarojnë se një njësi ekonomike aplikon SNRF 9 për interesat afatgjata në sipërmarrje të përbashkëta, për të cilën nuk zbatohet metoda e kapitalit, por që, në thelb, përbëjnë një pjesë të investimit neto në Shoqëri ose sipërmarrje të përbashkëta (interesa afatgjatë).

Ndryshimi i planit, reduktimi ose zgjidhja - Ndryshimet në SNK 19: Ndryshimet adresojnë kontabilitetin kur kemi një ndryshim në plan, shkurtim ose shlyerje gjatë periudhës se raportimit.

Përmirësimë vjetore për ciklin 2015 – 2017 (publikuar më Dhjetor 2017):

- SNRF 3 Kombinimet e Biznesit - Interesat e mbajtura më parë në një operacion të përbashkët;

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 *(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)*

4. Ndryshimet në politikat kontabël (vazhdim)

B. Standarde të tjera dhe ndryshime (vazhdim)

- SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta - Interesat e mbajtura më parë në një operacion të përbashkët;
- SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat - Pasojat e tatimit mbi të ardhurat nga pagesa në instrumentet financiare të klasifikuara si kapital;
- SNK 23 Kostot e huamarjes - Kostot e huamarjes të përshtatshme për kapitalizim.

5. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare, përvèç riklasifikimit te paraqitur ne shënimin 5 (t) krahasueset.

(a) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

(b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, përvèç kapitalit, që maten me kosto historike konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, përvèç kapitalit, që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat që vijnë nga konvertimet njihen në humbje ose fitim.

(c) Të ardhura/ shpenzime nga interesit

Sipas SNK 39 dhe SNRF 9 të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në fitim ose humbje bazuar në metodën efektive te interesit. Norma efektive e interesit është norma që skonton arkëtimet dhe pagesat e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së aktivit ose detyrimit financiar

- vlerën bruto të mbetur te aktivit financiar ose
- kosto e amortizuar te detyrimit financiar.

Gjatë përllogaritjes së normës efektive të interesit për instrumentet financiare të ndryshëm nga aktivet e blera ose aktive te gjeneruara te zhvlerësuara, Shoqëria vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo ECL. Për aktivet financiare të blera ose aktivet e gjeneruara te zhvlerësuara, llogaritet norma efektive e interesit të rregulluar nga zhvlerësimi i kredisë duke përdorur flukset monetare të ardhshme duke përfshirë dhe ECL. Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin kostot dhe tarifat e transaksionit dhe njësitë e paguara ose të pranuara që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të një aktivi ose detyrimi financiar.

Norma efektive e interesit llogaritet me njohjen për here te pare të aktivit financiar ose detyrimit financiar. Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit, norma efektive e interesit llogaritet mbi vlerën bruto të mbetur të aktivit (kur aktivi nuk është i zhvlerësuar) ose me koston e amortizuar të detyrimit. Norma efektive e interesit rishikohet si rezultat i rivlerësimit periodik të flukseve të monetare të instrumenteve me normë të ndryshueshme për të pasqyruar lëvizjet në normat e interesit të tregut.

Shoqëria llogarit të ardhurat e interesit nga aktivet financiare, të tjera nga ato qe janë konsideruar si të zhvlerësuara, duke përdorur normë efektive interesit (NEI) mbi vlerën bruto të mbetur të aktivit financiar.

Kur një aktiv financiar ka humbje te vlerës se kredisë (siç është përcaktuar në shënimin 5(vii) dhe për më tepër është në Klasën 3, Shoqëria llogarit të ardhurat nga interesit duke përdorur NEI në vlerën neto të amortizimit të aktivit financiar. Nëse aktivi financiar rregullohet "rikuperohet" (siç është përshkruar në shënimin 5(vii)) dhe nuk është me e kategorizuar si kredi e vonuar, Shoqëria ndryshon llogaritjen e të ardhurave nga interesit ne vlerën bruto.

Llogaritja e të ardhurave nga interesit duke përdorur metodën efektive te interesit përfshin interesat nga aktivet të matura me kosto të amortizuar; shpenzimet e interesit përfshijnë interesin nga detyrimet financiare të matura me kosto të amortizuar.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 *(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)*

5. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(d) Tarifa dhe komisione

Shoqëria krijon të ardhura nga tarifat dhe komisionet nga një shumëlojshmëri shërbimesh financiare që u ofron klientëve të saj. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet njihen në atë masë që pasqyron shumën për të cilën Shoqëria pret të ketë të drejtë të marrë në këmbim të ofrimit të shërbimeve.

Detyrimet e performancës, si dhe kohëzgjatja e marries së tyre, identifikohen dhe përcaktohen në fillim të kontratës. Kontratat e të ardhurave të Shoqërisë zakonisht nuk përfshijnë detyrime të shumta të performancës.

Kur Shoqëria ofron një shërbim për klientët e saj, shërbimi faturohet përgjithësisht pas përfitimit të menjëhershëm të shërbimit të ofruar në datën e caktuar ose në fund të kontratës për një shërbim të ofruar për një periudhë te caktuar kohore.

Të ardhura nga tarifat ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- *Të ardhura nga tarifat e shërbimeve financiare kur përbushja e detyrimeve të performancës është e kënaqshme në një moment të caktuar:*
 - *Tarifat e Brokerimit:* Shoqëria vepron si ndërmjetës për shitjen e kontratave të sigurimit në emër të shoqërisë së sigurimit dhe merr një komision fiks për çdo transaksion. Detyrimi I Shoqërisë është të ekzekutojë marrëveshjen në emër të shoqërisë së sigurimit dhe të ardhurat njihen pasi të kryhet çdo marrëveshje (në datën e marrëveshjes). Pagesa e komisionit kryhet në fund të muajit. Pagesa e komisionit zakonisht bëhet në datën e transaksionit
 - *Tarifa të tjera:* I referohet verifikimit të kredisë sipas kërkesës së klientit. Tarifat e marra në këmbim të këtyre shërbimeve njihen në momentin e kryerjes së transaksionit pasi klienti merr vetëm përfitimet e performancës së Shoqërisë vetëm pas përfundimit të suksesshëm të transaksionit kryesor. Shoqëria ka të drejta mbi tarifën vetëm pas përfundimit të transaksionit.

Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

Shpenzime të tjera për tarifa dhe komisione që lidhen kryesisht me tarifat e transaksioneve dhe shërbimeve dhe jo me dhënien e kredive ndaj klientëve, shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

(e) Qiratë

Politikë e aplikuar para 1 Janar 2019

Përcaktimi nëse një marrëveshje është qira, ose përmban qira, bazohet në përbajtjen e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi specifik ose nëse marrëveshja përcjell një të drejtë për të përdorur aktivin.

Shoqëria si qiramarrës

Qiradhënet që nuk i transferojnë Shoqërisë në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rastësishme nga pronësia e sendeve të marra me qira janë qiratë operative. Kontrata me qira operative njihet si shpenzim në periudhën në të cilën ato ndodhin në mënyrë lineare përgjatë jetëgjatësisë së kontratës. Kontratat e qirasë me kusht janë njojur shpenzim i periudhës në periudhën kur kanë ndodhur. Stimujt e qirasë të marra njihen si pjesë përbërëse e shpenzimit të përgjithshëm të qirasë, gjatë afatit të qirasë.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 *(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)*

5. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Qiratë (vazhdim)

Politikë e aplikuar prej 1 Janar 2019

Shoqëria vlerëson në fillim të kontratës nëse një kontratë është, ose përmban një qira. Kjo do të thotë që, nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivitë identifikuar për një periudhë kohe të caktuar në këmbim të vlerësimit.

Shoqëria si qiramarrës

Shoqëria zbaton një njohje dhe model matjeje të vetme për të gjitha qiradhëni përvëçse qirave afatshkurra dhe qirave me aktiv me vlerë të vogël. Shoqëria njeh detyrimet e qirasë për të bërë pagesa të qirasë dhe aktive me të drejtë përdorimi që përfaqësojnë të drejtën e përdorimit të aktiveve në fjalë.

Aktiv me të drejtë përdorimi

Shoqëria njeh aktiv me të drejtë përdorimi në datën e fillimit të qirasë. Aktivi me të drejtë përdorimi matet me kosto duke zbritur amortizimin apo humbjet nga zhvlerësimi duke u rregulluar me çdo rivlerësim të detyrimit të qirasë. Kostoja e aktiveve me të drejtë përdorimi përfshin totalin e detyrimeve të qirasë të njohur, kostot direkte fillestare të bëra dhe pagesat e qirasë të bëra në ose para datës së fillimit, duke e pakësuar me çdo stimul të qirasë të marre. Aktivet me të drejtë përdorimi zhvlerësohen në bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Afatet e qirasë sipas ndarjeve janë si vijon: Ndërtesa - nga 2 deri në 5 vjet, Automjete – 4 vjet.

Aktivet me të drejtë përdorimi janë paraqitur në shënimin 19 Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe aktive me të drejtë përdorimi.

Detyrimet e qirasë

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njeh detyrimet e qirasë, të matura në vlerën aktuale të pagesave të qirasë që do të kryhen gjatë afatit të qirasë. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesa fiksë (minus çdo stimul të arkëtueshëm), pagesa të ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose normë, dhe shumat që pritet të paguhën nën garancitë e vlerës së mbetur. Pagesat e qirasë përfshijnë gjithashtu çmimin e ushtrimit të një opzioni blerjeje në mënyrë të arsyeshme që do të ushtronhet nga Shoqëria dhe pagesa të gjobës për ndërprerjen e qirasë, nëse qiraja reflekton ushtrimin e opzionit për të përfunduar. Pagesat e bëra të qiradhënis operative njihen në fitim ose humbje në bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Stimujt e marrë nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e shpenzimit të përgjithshëm të qirasë, gjatë afatit të qirasë. Detyrimet e qirasë paraqiten nën zërin detyrime të tjera.

(f) Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në humbje ose fitim përvëç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital, ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Interesat dhe penalitetet që lidhen me tatimin mbi të ardhurat, duke përfshirë trajtimet e pasigurta tatimore, trajtohen sipas SNK 37 *Provizonet, Detyrimet dhe aktivet e Kushtëzuara*.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose arkëtohet mbi fitimin ose humbjen e tatueshme të vitit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshmë për vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshmë ose të arkëtueshëm është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit që pritet të paguhet ose të merret, i cili reflekton pasigurinë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat, nëse ka. Ai matet duke përdorur normat e taksave të miratuara ose të miratuara në mënyrë thelbësore në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet tatimore aktuale janë kompensuar (netuar) vetëm nëse plotësohen disa kritere.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 *(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)*

5. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Shpenzim i tatimit mbi fitim (vazhdim)

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet lidhur me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerave te mbartura te aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerat e përdorura për qëllime tativore.

Një aktiv tativor i shtyrë njihet për humbjen tativore të papërdorur, kreditimet tativore të papërdorura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundur që të kenë fitime të tatushme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Fitimet e ardhshme të tatushme përcaktohen në bazë të planeve të biznesit. Aktivet tativore te shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që të realizohet përfitim fiskal; Këto zvogëlime rimerren, kur mundësia e fitimit të ardhshëm tativor përmirësohet.

Aktivet tativore të shtyra të panjohura rishikohen në çdo datë raportimi dhe njihen për aq sa është e mundur që përfitimi tativor të realizohet. Tatimi i shtyrë matet me normat tativore që pritet të zbatohen mbi diferencat e përkohshme të cilat kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose miratuar në datën e raportimit financiar.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tativore që do duhet të ndiqen nga mënyra se si Shoqëria pret, në datën e raportimit, të rikuperojë ose shlyejë vlerën e mbartur të aktiveve ose detyrimeve të veta. Aktivi tativor i shtyrë kompensohet me detyrimin tativor të shtyre vetëm në qoftë se kritere të caktuara përbushen.

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Shoqëria fillimisht njeh huatë dhe paradhënet në datën kur ato krijohen.

Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen në datën e tregtimit, në të cilën Shoqëria është palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar është matur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për çdo njësi jo pjesë e vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes , kostot e transaksionit janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen apo emetimin e tyre.

(ii) Klasifikimi

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur me: koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet te ardhurave te tjera gjithëpërfshirëse ose vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Një aktiv financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar sime vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes :

- aktivi mbahet sipas modelit të biznesit objektivi i të cilil është mbajtja e aktivit për tu arkëtar: dhe flukset kontraktuale monetare dhe kushtet kontraktuale të aktivit financiar të cilat lindin në datat specifike të flukseve monetare të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit (SPPI).

Instrumentet e borxhit të matshme si me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet dhe nuk janë përcaktuar si vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes:

- aktivi mbahet sipas modelit të biznesit objektivi i të cilil është arritja njëkohësisht mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe shitjen e aktiveve financiare;
- dhe kushtet kontraktuale të aktiveve financiare të cilat lindin në një datë specifike të flukseve monetare të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit SPPI.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)

5. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi (vazhdim)

Për njohjen fillestare të një investimi kapital i cili nuk mbahet për qëllime tregtimi, Shoqëria mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme të paraqesë ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë në OCI; Këto zgjedhje janë bërë në bazë të investimeve të njëpasnjëshme.

Të gjitha aktivet e tjera janë klasifikuar dhe matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Vlerësimi e modelit të biznesit

Në vlerësimin e objektivit të modelit të biznesit, Shoqëria konsideroi informacionin e mëposhtëm:

- Politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe veprimet e tyre në praktikë, duke përfshirë nëse strategjia e drejtimit fokusohet në krijimin e të ardhurave nga interesi kontraktual;
- Mënyra e vlerësimit dhe raportimit të performancës së portofolit tek drejtuesit e Shoqërisë;
- Rreziku qe ndikon performancën e modelit të biznesit (dhe aktivet financiare të mbajtura sipas atij modelit të biznesit) dhe si këto rreziqe menaxhohen; dhe
- Frekuencën e pritshme te shitjeve ne vlerën dhe kohë

Qasja e modelit të biznesit është bazuar në mënyrë të arsyeshme në skenarët e pritshëm pa marrë “skenarin më të keq” apo “skenarin nën stres” në llogaritje. Nëse flukset e mjeteve monetare, pas njohjes fillestare realizohen në një mënyrë që ndryshon nga pritshmëritë fillestare të shoqërisë, Shoqëria nuk ndryshon klasifikimin e aktiveve të mbetur financiare të mbajtura në atë model biznesi, por përfshin këtë informacion gjatë vlerësimit të aktiveve financiare të sapo krijuara ose te blera.

Shoqëria klasifikon aktivet e veta financiare duke u bazuar në modelin e biznesit, mbajtur për tu arkëtar.

Vlerësimet nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa të vetme të principalit dhe interesit.

Në vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa të vetme të principalit dhe interesit, Shoqëria konsideron termat kontraktuale dhe Instrumentet. Kjo përfshin vlerësimin nëse aktivi financiar përban terma kontraktual të cilat mund të ndryshojnë kohen ose shumen e flukseve hyrëse aq sa mund te mos përbushë këtë kusht.

Për qëllime të këtij vlerësimi “Principal” është përcaktuar me vlerën e drejtë të aktivit financiar në njohjen fillestare. “Interesi” është përcaktuar si vlera në kohë e parasë për këtë rrezik të lidhur me shumën e papaguar të principalit në një periudhë të caktuar duke përfshirë rrezikun bazë të kredisë dhe kostot (p.sh. rrezikun e likuiditetit dhe kostot administrative) gjithashu edhe marzhet e fitimit. Të gjitha aktivet financiare kane kaluar testin SPPI(pagesa të vetme të Principalit dhe interesit) dhe aktivet financiare janë njohur me vlerë të mbetur.

Riklasifikimi

Aktivet financiare nuk janë riklasifikuar pas njohjes së tyre fillestare, përvçe se në periudhën pasi Shoqëria ndryshoi modelin e biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare. Nuk ka klasifikime të ndodhura gjatë vitit 2019

(iii) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur ajo i transferon të drejtën kontraktuale për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivi financiar një pale tjetër, pa mbajtur kontrollin ose të gjitha rreziqet e pronësisë së aktivit financiar. Interesi nga aktivet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim i veçantë.

Në çregjistrimin e një aktivi financiar diferenca midis shumës së mbartur të aktivit (ose shumës së mbartur të shpërndarë sipas pjesës së aktivit të çregjistruar) dhe shume se (i) konsiderueshme për tu marrë (përfshirë çdo aktiv të ri të marrë duke zbritur detyrimet e reja të supozuara) dhe (ii) çdo të ardhur ose humbje te akumuluar e cila është e njohur në OCI, njihet në fitim ose humbje.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 *(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)*

5. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Çregjistrimi (vazhdim)

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

Shoqëria kryen transaksione me anë të tē cilave transferon aktivet të njoitura në pasqyrën e pozicionit financiar, por në të njëjtën kohë mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse mbarten të gjitha rreziqet dhe përfitimet, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve ku ruhen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet, përfshin huadħien e letrave me vlerë dhe transaksionet e riblerjeve.

Kur aktivet i shiten një pale të tretë me një përqindje totale aktuale të shkëmbimit të kthimit mbi aktivet e transferuara, transaksiōni llogaritet si një transaksiōn financiar i siguruar i ngjashëm me transaksionet e riblerjes.

Në disa transaksione të caktuara ku Shoqëria as nuk mbart dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësise mbi aktivin financiar, ajo çregjistron aktivin nëse e humbet kontrollin mbi aktivin. Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura gjatë transferimit njihen më vete sipas rastit si aktive ose detyrime. Në transferime ku kontrolli mbi aktivin ruhet, Shoqëria vazhdon të njoħe aktivin sipas shkallës së përfshirjes së vazhdueshme të saj në aktivin financiar, e përcaktuar kjo nga masa e ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

(iv) Netimi

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera e tyre paraqitet neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetem, dhe vetem, nëse Shoqëria ka të drejtë ligjore t'i kompensojë dhe ka qëllim që të shlyejë në baza neto ose të fitojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në baza neto vetem kur kjo lejohet nga standartet e kontabilitetit ose kur ato shaktohen nga një grup i ngjashëm transaksiōnesh si pér shembull nga aktiviteti i Shoqërisë.

(v) Matja me kosto të amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në momentin filletar, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv pér çdo diferenca ndërmjet vlerës fillestare të njoħur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje pér efekt provizioni.

(vi) Matja me vlerë të drejtë

Vlera e drejtë është çmimi që do të pranohej pér të shitur një aktiv ose paguhej pér të transferuar një detyrim në një transaksiōn të zakonshëm në princip midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes, ose në mungesë të saj, në tregun më të favorshëm në të cilin Shoqëria ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një aktivi pasqyron rrezikun e mosekzekutimit.

Kur është e mundur, Shoqëria mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv pér atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse transaksiōn pér një aktiv ose detyrim ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm pér të siguruar informacion të çmimeve në baza të vazhdueshme.

Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknika vlerësimi të cilat maksimizojnë përdorimin e tē dhénave të mbikëqyrura dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo tē vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do tē marrin parasysh në vendosjen e çmimit të një transaksiōni.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 *(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)*

5. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vi) Matja me vlerë të drejtë (vazhdim)

Treguesi më i mirë i vlerës së drejtë të një instrumenti finanziar në njojen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose arkëtar. Nëse Shoqëria përcakton se vlera e drejtë në njojen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk përcaktohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim të ngjashëm dhe as nuk bazohet në një teknikë vlerësimi që përdor të dhëna të njoitura në tregje, atëherë instrumenti finanziar matet fillimi me vlerën e drejtë, dhe rregullohet për diferencën midis vlerës së drejtë në njojen fillestare dhe çmimit të transaksionit.

Në vijim, diferenca njihet në pasqyrën e të ardhurave siç duhet gjatë gjithë kohëzgjatjes së instrumentit, por jo më vonë se periudha kur vlerësimi është plotësisht i mbështetur me të dhëna të njoitura në treg ose kur mbyllët transaksioni.

Shoqëria mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e metodës së mëposhtme:

- Niveli 1: Çmimi I tregut në një treg aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknikat e vlerësimit bazuar në inputet e vëzhguara. Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuara sipas: çmimit të tregut në një treg aktiv për një instrument të ngjashëm, çmime tregu për instrumente të ngjashëm në tregje të cilat konsiderohen më pak se aktive ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjithë inputet e rëndësishme janë të matshme në mënyre direkte ose indirekte nga tregu.
- Niveli 3: Teknikat e vlerësimit duke përdorur inpute të rëndësishme të pakontrollueshme. Kjo kategori përfshin të gjitha instrumentet kur teknikat e vlerësimit përfshijnë inpute jot ë bazuara në të dhënat e mbikëqyrura dhe inputet e pakontrolluara mund të kenë një efekt domethënës në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që vlerësohen bazuar në çmimet e kuotuara për instrumente të ngjashme, kur kërkohen rregullime apo supozime të konsiderueshme të pa kontrollueshme për të pasqyruar ndryshimet midis instrumenteve

(vii) Zhvlerësimi

Shoqëria njeh një fond për humbje i cili është i barabartë më jetëgjatësinë e ECL në instrumentet financiare, të cilat janë matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

- aktive financiare të cilat janë instrumente borxhi

Shoqëria mat humbjen në një vlerë të barabartë me ECL përgjatë gjithë jetës se aktivit, perveçse në rastet për të cilat ato maten si ECL 12 mujore:

- investime në letra më vlerë të cilat kanë rezik të ulët të kredisë në datën e raportimit dhe
- instrumente të tjera financiare (të tjera nga të arkëtueshme nga qiraja financiare) në të cilin reziku nuk është rritur në mënyrë të rëndësishme që në momentin e njojjes.

ECL12-mujore është ajo pjesë e ECL që rrjedh nga ngjarjet e mospagesës së një instrumenti finanziar të cilat janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit.

Instrumentet financiare për të cilat njihet një ECL12 mujore quhen 'Instrumentet financiare të Klasës 1'. ECL përgjatë gjithë jetës është ECL që rrjedh si rezultat i të gjitha ngjarjet te mundshme të mospagesave te paracaktuara gjatë jetës së instrumentit financiar. Instrumentet financiare për të cilat njihet ECL përgjatë gjithë jetës, por që nuk janë kredi zhvlerësuara referohen si 'Instrumentet financiare të Klasës 2'.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 *(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)*

5. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Zhvlerimi (vazhdim)

Matja e ECL

ECL është vlerësim i humbjeve të kredisë me probabilitet të ponderuar. Ato maten si më poshtë:

- Aktivet financiare të cilat nuk janë zhvlerësuar në datën e raportimit si vlera aktuale mjeteve monetare të munguara (psh.diferenca midis flukseve monetare të cilat i detyrohen njësisë ekonomike bazuar mbi kontratat dhe flukseve monetare qe Grupi pret të marrë)
- Aktivet financiare të cilat janë të zhvlerësuara në datën e raportimit: si një diferenca midis shumës bruto të mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme te vlerësuara monetare. Inputet kryesore për matjen e ECL janë struktura baze PD, LGD dhe variablat EAD. Informacione të zgjeruara se si janë përllogaritur janë të detajuara në shënimet e rrezikut financiar 6.b.ii)

Paraqitura e fondit të ECL-në pasqyrën e pozicionit financiar

Fondi i humbjes se kredisë ECL është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë: aktivet financiare të matura me koston e amortizuar i zbritur nga vlera bruto e mbartur e aktiveve.

Fshirjet nga pasqyrat financiare

Kreditë dhe letrat me vlerë të borxhit fshihen (pjesërisht ose tërësisht) kur nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e një aktivi financiar në tërësinë ose një pjesë të tij. Kjo zakonisht ndodh kur Shoqëria përcaktzon se huamarrësi nuk ka aktive ose burime të ardhurash të cilat gjenerojnë flukse të mjaftueshme monetare për të shlyer shumat të cilat janë subjekt i fshirjes. Ky vlerësim bëhet për çdo aktiv individualisht. Shumat e rimarra nga fshirjet e mëparshme paraqiten veçantë në "Fitimi neto nga rimarrja e kredive dhe paradhëniet e klienteve" në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Aktivet financiare të cilat janë fshirë mund të janë subjekt i veprimeve përmbarimore në përputhje me procedurat e Shoqërisë për rikuperimin e kredive. Më 31 Dhjetor 2019, aktivet financiare të fshira janë akoma subjekt i aktiviteteve plotësues në vlerën 144,251 mijë LEK (2018: 116,097 mijë LEK)

Përcaktimi i mospagesës

Shoqëria e konsideron një aktiv financiar te zhvlerësuar apo në Klasën 3(kredi e zhvlerësuar)për përllogaritjen e ECL në të gjitha rastet kur huamarrësi është 90 ditë në vonesë në pagesat e tij sipas kontratës.

Evidencia objektive të zhvlerësimit

Si pjesë e vlerësimit sasior, nëse një klient është në mospagesë, Shoqëria konsideron një tërësi rastesh të cilat mund te tregojnë dëshirë për mospagesë. Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse aktivet financiare të mbajtura me koston e amortizuar janë kredi te zhvlerësuara (referuar si 'Aktivet financiare të Klasës 3'). Një aktiv financiar është kredi e zhvlerësuar kur ka ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim të dëmshëm në flukset monetare të ardhshme të vlerësuara të aktivit financiar . Fakti që një aktiv financiar është kredi jo performuese përfshin të dhënat vijuese:

- vështirësi të theksuara financiare të huamarrësit
- prishje e kushteve te kontratës si mospagesë ose rezultat i një ngjarjeje të ndodhur ne te kaluarën
- një ristrukturim i kredisë në terma që Shoqëria
- është e mundshme që huamarrësi të hyjë në falimentim ose riorganizim tjetër financiar; ose
- një hua që është rinegociuar për shkak të përkeqësimit të gjendjes së huamarrësit zakonisht konsiderohet të jetë kredi jo performuese nëse nuk ka dëshmi se rreziku i mosmarrjes së flukseve monetare kontraktuale është reduktuar ndjeshëm dhe nuk ka indikatorë të tjera të zhvlerësimit.

Është në politikën e Shoqërisë që të përcaktojë nëse një instrument financiar i devijuar është "kuruar" dhe për më tepër është klasifikuar jashtë Klasës 3/Klasës 2, kur nuk ka asnjë indikacion për zhvlerësim për minimalisht 9 muajt te njëpasnjëshëm.

NOA SH.A.

Shënimë shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 *(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)*

5. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Zhvlersimi (vazhdim)

Kredi të ristrukturuar

Shoqëria në disa raste kryen modifikime të kushteve origjinale të kredisë si një përgjigje ndaj vështirësive financiare të huamarrësit, në vend qe të marrë në posedim ose të zbatojë mbledhjen e kolateralit. Shoqëria e konsideron një kredi të ristrukturuar kur këto modifikime vijnë si rezultat i pamundësisë financiare të huamarrësit dhe Shoqëria nuk do të kishte rënë dakord me këto rregullime nëse huamarrësi do të ishte financiarisht i shëndetshëm. Treguesit e vështirësive financiare përfshijnë mos-pagine sipas marrëveshjes, ose shqetësimë të konsiderueshme ngritur nga Departamenti i Riskut të Kredisë. Devijimi mund të përfshijë zgjatjen e marrëveshjes së pagesave dhe marrëveshje dhe kushteve të reja të kredisë. Me rinegocimin e kushteve të reja, matet provigjoni duke përdorur normën efektive te interesit te përllogaritur përpara modifikimit të kushteve të kredisë. Është politika e

Kredi të ristrukturuar (vazhdim)

Shoqërisë për të monitoruar kreditë e ristrukturuar e për të ndihmuar që pagesat e ardhshme të jenë të sigurta të ndodhin.

Vendimi i çregjistrit dhe klasifikimi midis Klasës 2 dhe 3 janë përcaktuar rast pas rasti. Nëse kjo procedure identifikon një humbje në lidhje me një kredi, e cila është përcaktuar dhe menaxhuar si e provigionuar “Klaza 3”, aktivi është i ristrukturuar derisa sa mblidhet ose fshihet.

Shoqëria çregjistron një aktiv financier, të tilla si kredi dhe paradhënie ndaj klientëve, kur janë rinegociuar afatet dhe kushtet për shtyrje, në thelb behet kredi e re, ndryshimi njihet si fitim ose humbje nga çregjistimi, deri në masën ne të cilën humbja nuk është regjistruar. Kreditë e reja të njoftura klasifikohet si Klaza 1 e ECL për qëllime matjeje përveç nëse kredia konsiderohet POCI. Kur vlerësohet një kredi për një klient nëse duhet të çregjistrohet apo jo, përmes faktorëve cilësorë, Shoqëria konsideron faktorët e mëposhtëm:

- Ndryshime në monedhën e kredisë
- Ndryshime në maturitet për më shumë se 50%;
- Ndryshime në palët e kontratës
- Nëse ndryshimet në instrument nuk përputhen me kriterin SPPI

Kur kredia është rinegociuar ose modifikuar por jo çregjistuar, Shoqëria rivlerëson nëse ka patur një rritje të rëndësishme në rrezikun e kredisë. Shoqëria gjithashtu vlerëson nëse kredia duhet të klasifikohen si Klaza 3.

Një herë që aktivë është klasifikuar si i devijuar, do të mbetët i tillë për një periudhe minimalisht 9 mujore si një periudhë prove. Në mënyrë që kredia të klasifikohet jashtë kategorisë së kredive të ristrukturuar, klienti duhet të përbushë kriteret e mëposhtme:

- Pas të gjitha lehtësimeve duhet të konsiderohet kredi performuese.
- Periudha e provës prej 9 muajsh ka kaluar nga data kur kontrata e ristrukturuar është konsideruar performuese.
- Pagesa të rregullta te principalit dhe interesit janë bërë gjatë gjysmës së dytë të periudhës së provës.
- Klienti nuk ka asnë këst ne më shumë se 30 ditë vonesë.

(h) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë, gjendje të pakushtëzuara në banka dhe të tjera aktive financiare afatshkurtra me maturitet tre mujor ose më të vogël, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga Shoqëria në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to mbahen në pasqyrën e pozicionit finansiar me koston e amortizuar.

NOA SH.A.

Shënimë shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 (Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)

5. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(i) Hua dhe paradhënie

Shoqëria mat "Hua institucioneve financiare", "Huatë dhe paradhëni e klientëve" dhe investimet e tjera financiare me kosto të amortizuar nëse të gjitha kushtet e mëposhtme plotësohen:

- Një aktiv financiar është mbajtur sipas modelit të biznesit me objektiv: për të mbajtur aktivin financiar në mënyre që të mbledhë flukset kontraktuale monetare.
- Kushtet kontraktuale të aktivit të financiar përcaktojnë datat e flukseve monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit (SPPI) në shumën mbetur të papaguar.

(j) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe aktive me të drejtë përdorimi

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes së pajisjeve dhe restaurimin e ambientit ku ato janë vendosur. Kur pjesë të ndryshme të një aktivit të qëndrueshëm të trupëzuar kanë jetëgjatësinë të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (pjesët kryesore të tyre). Aktivet me të drejtë përdorimi paraqiten së bashku me aktivet afatgjata materiale-referojuni politikes së kontabilitetit në shënimin 5 (e).

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një elementi të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara njihet në vlerën mbartur të njësiesë nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të vijnë në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri.

Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara njihen në humbje ose fitim në momentin kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në humbje ose fitim në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të çdo zëri të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara. Aktivet e marra me qira zhvlerësohen gjatë periudhës më të shkurtër ndërmjet kohëzgjatjes së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Jeta e dobishme për vitin aktual dhe paraardhës është si më poshtë:

Pajisje elektronike	4 vite
Automjete	4 vite
Pajisje dhe mobilje	5 vite
Përmirësimi të ambienteve të marra me qira	4 vite

Një njësi ose çdo pjesë fillestare të njohura të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara çregjistrohet nëse asgjësimi (d.m.th., në datën kur marrësi merr kontrollin) ose kur nuk pritet përfitime ekonomike në të ardhmen nga përdorimi ose asgjësimi i tij. Çdo fitim ose humbje që rrjedh nga çregjistrimi i aktivit (ilogaritur si diferenca midis të ardhurave të asgjësimit neto dhe vlerës së mbartur të aktivit) përfshihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur aktivit çregjistrohet.

Metoda e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 *(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)*

5. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(k) Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara

Programet kompjuterike dhe licensat e blera nga Shoqëria njihen me koston historike të zvogëluar me amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi.

Shpenzime vijuese për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime ndikojnë në rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik të aktivit të cilët i ngarkohen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin.

Amortizimi njihet në humbje ose fitim në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të programit kompjuterik duke filluar nga data në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme e programeve kompjuterike është 1-2 vjet.

(l) Inventari

Aktivet e tjera janë të përbëra nga aktivet e marra në zotërim nëpërmjet procesit të arkëtitimit të huave me probleme, që nuk sjellin qera, dhe nuk përdoren nga Shoqëria dhe kanë si qëllim shitjen në një kohë të shkurtër pa nevojën e një ristrukturimi të rëndësishëm. Aktivet e marra në zotërim maten me vlerën më të vogël ndërmjet kostos dhe vlerës së realizueshme neto dhe çdo zhvlerësim njihet në fitim ose humbje.

(m) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përvèç aktiveve tativore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në humbje ose fitim.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale, duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Humbjet nga zhvlerësimi të njoitura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për evidenca nëse humbja është zvogëluar ose nuk ekziston më. Një humbje për zhvlerësim anulohet nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël, që do të përcaktohej duke i zbritur zhvlerësimin, sikur të mos ishte njojur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(n) Huatë

Huatë fillimisht maten me vlerën e drejte minus kostot direkte rritëse te transaksionit, më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Huamarrjet përbajnjë kushte, të cilat nëse tejkalojnë, i bëjnë huamarrjet të ripagueshme sipas kërkesës dhe të klasifikuara si detyrime afatshkurtra, përvèç nëse hiqet dorë nga huadhënësi.

(o) Obligacionet e emetuara

Obligacionet e emetuara fillimisht maten me vlerën e drejte minus kostot shtesë të drejtpërdrejta të transaksionit dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Ky vlerësim është vlerësimi më i rëndësishëm bazuar mbi vlerën e drejte të obligacionit.

NOA SH.A.

Shënim shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)

15. Tatimi mbi fitimin

	2019	2018
Shpenzim tatim fitimi aktual	49,628	41,810
Të ardhura/(shpenzime) tatile të shtyra	1,647	(7,081)
Total shpenzim tatim fitimi	51,275	34,729

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri vlerësohet në normën 15% të fitimit të tatushëm. Më poshtë janë paraqitur tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë, të njojur ne fitim ose humbje. Më poshtë është një rakordim i normës efektive të tatimit:

	Norma efektive e tatimit	2019	Norma efektive e tatimit	2018
Fitimi para tatimit		325,590		210,124
Te ardhura të tatushme 15%	15.00%	48,839	15.00%	31,519
Shpenzimet e pazbritshme	0.54%	1,746	1.66%	3,492
Të ardhura të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat	-0.29%	(956)	3.24%	6,799
Shpenzim tatim fitimi neto	15.24%	49,628	19.90%	41,810

Tatim fitimi i parapaguar për vitin 2019 është 38,532 mijë Lek (2018: 28,270 mijë Lek). Më poshtë paraqitet një barazim midis fitimit kontabël dhe tatim fitimit.

	2019	2018
Fitimi para tatimit	325,590	210,124
<i>Shpenzime të pazbritshme</i>	<i>11,638</i>	<i>23,280</i>
SNRF 16 – Të drejta ndaj aktiveve (shpenzime të njoitura sipas PBT)	45,964	-
SNRF 16 - Të drejta ndaj aktiveve (shpenzime qiraje)	(44,279)	-
Shpenzime të tjera të pazbritshme	9,952	23,280
<i>Të ardhura të përjashtuara si rezultat i ndryshimit të politikës kontabël në kuotat e aplikimit</i>	<i>(6,374)</i>	<i>45,327</i>
Të ardhura të tatushme	330,854	278,731
Norma e tatim fitimit	15%	15%
Shpenzim tatim fitimi	49,628	41,810

Aktivi tatimor I shtyrë më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 është si më poshtë vijon:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Aktiv tatimor I shtyrë:		
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	5,628	7,272
Aktive të qëndrueshme të pa trupëzuara	3,209	2,508
Rezerva e humbjes nga kreditë(përdorimi për herë të parë SNRF9)	3,959	3,959
Hua dhe paradhënie klientëve, neto	12,667	13,623
Aktiv tatimor i shtyre SNRF 16	18,999	-
Detyrim tatimor I shtyrë:		
Detyrim tatimor I shtyre SNRF 16	(18,746)	-
Aktiv tatimor I shtyrë, neto	25,715	27,362

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 (Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)

15. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Tatim fitimi I shtyrë për fundin e vitit 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2019 paraqitet në tabelën më poshtë si vijon:

	Fund viti 31 Dhjetor 2019	Fund viti 31 Dhjetor 2018
Ndryshimi në aktivin tatimor të shtyrë:		
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	(1,644)	80
Aktive të qëndrueshme të pa trupëzuara	701	202
Hua dhe paradhënie klientëve, neto	(956)	6,799
SNRF 16	18,999	-
Ndryshimi në detyrimin tatimor të shtyrë:		
SNRF 16	(18,746)	
Ndryshimi neto	(1,647)	7,081

16. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Mjete monetare në arkë	3,014	2,392
Llogari rrjedhëse	324,677	226,636
Total	327,691	229,028

Nuk ekziston një klasifikim i jashtëm për bankat që operojnë në Shqipëri, për këtë arsyre nga vlerësimi individual i kryer për shoqërinë nuk rezultoi të kishte ndonjë zhvlerësim të gjendjes së mjeteve monetare dhe ekuivalentëve me to.

17. Hua Institucioneve Financiare

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Hua institucioneve financiare	540,659	52,794
Minus provizionet	-	-
Total	540,659	52,794

Sic është paraqitur në Shënimin 5, Hua Institucioneve Financiare më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 janë paraqitur neto nga gjendja e overdrafteve me vlerë respektivisht prej 1,983,214 mijë Lek (2018: 1.918,252 mijë Lek). Maturiteti mesatar dhe norma mesatare e interesit për huatë në Euro dhe Lek është respektivisht 12 muaj me normën 0.11% (2018: 0.28%).

Nuk ekziston një klasifikim i jashtëm për bankat që operojnë në Shqipëri, për këtë arsyre nga vlerësimi individual i kryer për shoqërinë nuk rezultoi të kishte ndonjë zhvlerësim të "Hua institucioneve financiare". Balanca e "Hua institucioneve financiare" është rritur në Dhjetor 2019 krahasimisht me Dhjetor 2018 si rezultat i mos arritjes së volumit të disbursimeve.

NOA SH.A.

Shënimë shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 (Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)

18. Hua dhe paradhënie klientëve, neto

Huatë dhe paradhëni e klientëve përfundin e vitit 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

	31Dhjetor 2019	31Dhjetor 2018
Hua dhe paradhënie klientëve, bruto	5,105,073	4,809,785
Interesi i përllogaritur	82,665	73,912
Komisione te tjera	1,310	954
Ripagesa të parakohshme	(78,387)	(84,059)
Rezerva e provizionit	(404,784)	(400,969)
	4,705,878	4,399,623

	31Dhjetor 2019			31Dhjetor 2018		
	Vlera bruto	ECL	Vlera neto	Vlera bruto	ECL	Vlera neto
Individë	880,005	112,831	767,174	695,935	98,435	597,500
Biznes	4,307,733	291,532	4,015,781	4,187,760	302,533	3,885,227
Total	5,187,739	404,784	4,782,955	4,883,696	400,968	4,482,728

Kredi për Individ

	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Total
Vlera bruto më 1 Janar 2019	614,156	23,202	58,578	695,935
Kredi të reja të disbursuara ose të blera	542,333	-	-	542,333
Kredi të fshira ose të shlyera	(296,754)	(11,235)	(14,026)	(322,015)
Transferuar në Klasën 1	766	(766)	-	-
Transferuar në Klasën 2	(68,097)	68,278	(181)	-
Transferuar në Klasën 3	(29,786)	(46,323)	76,110	-
Kredit te fshira	-	-	(36,248)	(36,248)
Këndim i kreditit	-	-	-	-
Vlera bruto më 31 Dhjetor 2019	762,618	33,156	84,232	880,006

	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Total
Rezerva ECL më 1 Janar 2019	16,025	6,940	60,926	83,891
Kredi te disbursuara ose të blera	54,327	-	-	54,327
Kredit te fshira ose të shlyera	(5,175)	(1,672)	(1,021)	(7,868)
Transferuar në Klasën 1	15	(15)	-	-
Transferuar në Klasën 2	(44,349)	44,382	(33)	-
Transferuar në Klasën 3	(9,503)	(41,269)	50,772	-
Riklasifikuar	(239)	796	(709)	(151)
Rimatja e ECL, neto	7,786	(778)	(11,707)	(4,699)
Kredi te fshira	-	-	(12,668)	(12,668)
Këndim i kreditit	-	-	-	-
Rezerva ECL më 31 Dhjetor 2019	18,886	8,386	85,559	112,831

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)

18. Hua dhe paradhënie klientëve, neto (vazhdim)

Kredia për Biznes

	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Total
Vlera bruto më 1 Janar 2019	3,830,302	147,543	209,915	4,187,760
Kredi të disbursuara ose të blera	1,640,445	-	-	1,640,445
Kreditë fshira ose të shlyera	(1,336,293)	(36,458)	(36,160)	(1,408,911)
Transferuar në Klasën 1	20,586	(20,586)	-	-
Transferuar në Klasën 2	(131,669)	133,284	(1,615)	-
Transferuar në Klasën 3	(99,236)	(60,062)	159,298	-
Kredi te fshira	-	-	(108,002)	(108,002)
Rregullim për kursin e këmbimit	(3,401)	(157)	(1)	(3,559)
Vlera bruto më 31 Dhjetor 2019	3,920,734	163,564	223,435	4,307,733

	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Total
Rezerva ECL më 1 Janar 2019	80,947	43,567	192,564	317,078
Kredi të disbursuara ose të blera	27,988	-	-	27,988
Kreditë fshira ose të shlyera	(16,298)	(3,607)	(33,061)	(52,966)
Transferuar në Klasën 1	269	(269)	-	-
Transferuar në Klasën 2	(37,153)	37,187	(34)	-
Transferuar në Klasën 3	(31,402)	(13,273)	44,675	-
Riklasifikuar	239	(87)	-	151
Rimatje ECL, neto	28,036	(7,859)	(2,017)	18,160
Kredi te fshira	-	-	(18,385)	(18,385)
Rregullim për kursin e këmbimit	(73)	-	(1)	(73)
Rezerva ECL më 31 Dhjetor 2019	52,552	55,660	183,741	291,953

Kredi për Individ

	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Total
Vlera bruto më 1 janar 2018	738,022	33,862	76,478	848,362
Kredi të disbursuara ose të blera	281,895	6,818	3,175	291,887
Kreditë fshira ose të shlyera	(371,174)	(11,138)	(21,850)	(404,162)
Transferuar në Klasën 1	4,561	(4,561)	-	-
Transferuar në Klasën 2	(12,119)	12,453	(334)	-
Transferuar në Klasën 3	(6,693)	(3,077)	9,770	-
Kredit te fshira	(20,336)	(11,155)	(8,661)	(40,152)
Rregullim për kursin e këmbimit	-	-	-	-
Vlera bruto më 31 Dhjetor 2018	614,156	23,202	58,578	695,935

	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Total
Rezerva ECL më 1 Janar 2018	19,948	11,423	67,970	99,341
Kredi të disbursuara ose të blera	7,892	2,223	3,303	13,418
Kreditë fshira ose të shlyera	(5,637)	(1,825)	(9)	(7,471)
Transferuar në Klasën 1	132	(132)	-	-
Transferuar në Klasën 2	(3,827)	3,903	(75)	-
Transferuar në Klasën 3	(6,322)	(3,055)	9,376	-
Riklasifikuar	(115)	(314)	196	(233)
Rimatja e ECL, neto	24,290	5,871	3,371	33,532
Kredi te fshira	(20,336)	(11,155)	(8,661)	(40,152)
Rregullim për kursin e këmbimit	-	-	-	-
Rezerva ECL më 31 Dhjetor 2018	16,025	6,939	75,471	98,435

NOA SH.A.

Shënimë shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)

18. Hua dhe paradhënie klientëve, neto (vazhdim) *Kredia për Biznes*

	Klaza 1	Klaza 2	Klaza 3	Total
Vlera bruto më 1 Janar 2018	3,220,476	120,248	195,682	3,536,406
Kredi e disbursuar ose blerë	1,850,230	16,536	15,444	1,882,210
Kredi të fshira ose të shlyera	(1,087,804)	(28,796)	(31,825)	(1,148,425)
Transferuar në Klasën 1	16,673	(16,673)	-	0
Transferuar në Klasën 2	(91,994)	95,453	(3,459)	0
Transferuar në Klasën 3	(35,873)	(3,420)	39,293	0
Kredi te fshira	(36,030)	(34,972)	(4,943)	(75,945)
Rregullim për kursin e këmbimit	(5,376)	(833)	(277)	(6,486)
Vlera bruto më 31 Dhjetor 2018	3,830,302	147,543	209,915	4,187,760

	Klaza 1	Klaza 2	Klaza 3	Total
Rezerva ECL më 01 Janar 2018	59,513	27,256	169,261	256,030
Kredi të disbursuara ose të blera	42,664	6,354	7,147	56,165
Kredi të fshira ose të shlyera	(11,304)	(4,100)	88	(15,316)
Transferuar në Klasën 1	257	(257)	-	-
Transferuar në Klasën 2	(29,798)	31,009	(1,211)	-
Transferuar në Klasën 3	(29,476)	(3,355)	32,831	-
Riklasifikuar	115	314	(196)	233
Rimatje ECL, neto	85,615	21,413	(23,415)	83,613
Kredi te fshira	(36,030)	(34,972)	(4,943)	(75,945)
Rregullim për kursin e këmbimit	(608)	(95)	(1,544)	(2,247)
Rezerva ECL më 31 Dhjetor 2018	80,948	43,567	178,018	302,533

NOA SH.A.

Shënimë shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 (Shumat në mijë Lek, përvçese kur shprehet ndryshe)

19. Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe Aktiv me të drejtë përdorimi

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

Kosto	Pajisje elektronike	Automjete	Pajisje dhe mobilje	Përmirësimi të ambienteve me qira	Ndërtesa	Automjete	Aktiv me të drejtë përdorimi	
							Total Aktiv me të drejtë përdorimi	Total Aktiv me të drejtë përdorimi
Më 1 Janar 2018	138,872	37,196	35,874	20,327	-	-	-	232,269
Shtesa	7,591	-	10,244	2,283	-	-	-	20,118
Pakësimë	(13,542)	(1,663)	(5,224)	-	-	-	-	(20,429)
Më 31 Dhjetor 2018	132,921	35,533	40,894	22,610	-	-	-	231,958
Efekti i përdorimit të SNRF 16 më 1 Janar 2019 (shënim 5s)	-	-	-	-	132,202	10,330	142,531	142,531
Shtesa	14,584	-	6,019	3,208	14,354	8,583	22,937	46,748
Pakësimë	(2,219)	(3,325)	(2,869)	-	-	-	-	(8,413)
Më 31 Dhjetor 2019	145,290	32,207	44,042	25,817	146,556	18,913	165,469	412,825
Zhvlerësimi i akumulatorëve								
Më 1 janar 2018	(123,088)	(32,335)	(31,286)	(18,481)	-	-	-	(205,190)
Zhvlerësim i vitiit	(8,013)	(4,735)	(1,900)	(1,046)	-	-	-	(15,694)
Pakësimë	13,542	1,663	4,963	-	-	-	-	20,168
Më 31 Dhjetor 2018	(117,559)	(35,407)	(28,223)	(19,527)	-	-	-	(200,716)
Zhvlerësim i vitiit	(7,766)	(127)	(4,037)	(1,688)	(37,087)	(3,410)	(40,497)	(54,114)
Pakësimë	2,210	3,325	2,790	-	-	-	-	8,325
Më 31 Dhjetor 2019	(123,116)	(32,207)	(29,471)	(21,213)	(37,087)	(3,410)	(40,497)	(246,505)
Vlera kontabëli neto								
Më 1 Janar 2018	15,784	4,861	4,588	1,846	-	-	-	27,079
Më 31 Dhjetor 2018	15,362	126	12,671	3,083	-	-	-	31,242
Më 31 Dhjetor 2019	22,174	-	14,571	4,604	109,469	15,503	124,972	166,320

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)

19. Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe Aktiv me të drejtë përdorimi (vazhdim)

Më poshtë janë paraqitur vlerat kontabël të detyrimeve të qirasë (përfshirë në 'Detyrime të tjera' në Shënimin 25) dhe lëvizjet gjatë periudhës:

	2019
Më 1 Janar – Efekti I përdorimit të SNRF 16	142,531
Shtesa	22,937
Interes shtesë	6,486
Pagesa	(44,279)
Efekti I kursit të këmbimit	(1,019)
Më 31 Dhjetor 2019	126,657

Analiza e maturitetit të detyrimeve të qirasë paraqitet në shënimin 6 (c) iii).

Shoqëria kishte flukse dalëse totale për qiratë në vlerën 44,279 mijë Lek. Zbatimi fillestar i SNRF 16 rezultoi me një shtesë jo monetare në aktiv me të drejtë përdorimi dhe detyrime qiraje më vlerë 142,531 mijë Lek më 1 Janar 2019.

20. Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara

	Programe kompjuterike dhe licenca	Total
<i>Kosto</i>		
Më 1 Janar 2018	179,032	179,032
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Më 31 Dhjetor 2018	179,032	179,032
Shtesa	5,443	5,443
Pakësime	-	-
Më 31 Dhjetor 2019	184,475	184,475
<i>Amortizim i akumuluar</i>		
Më 1 Janar 2018	(158,489)	(158,489)
Amortizimi i vitit	(10,707)	(10,707)
Pakësime	-	-
Më 31 Dhjetor 2018	(169,196)	(169,196)
Amortizimi i vitit	(9,238)	(9,238)
Pakësime	-	-
Më 31 Dhjetor 2019	(178,433)	(178,433)
<i>Vlera kontabël neto</i>		
Më 1 Janar 2018	20,543	20,543
Më 31 Dhjetor 2018	9,836	9,836
Më 31 Dhjetor 2019	6,041	6,041

NOA SH.A.

Shënimë shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)

21. Aktive të tjera

Me 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 aktivet e tjera janë të përbëra si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Inventari i kolateraleve të marra	9,840	11,428
Parapagime për zyrat e përmbarimit	6,413	6,704
Parapagime për shërbime IT	2,247	4,384
Sigurim Stafi	2,973	2,765
Te arkëtueshme nga palët e treta	2,294	4,410
 Të tjera	 4,114	 5,510
	27,881	35,201

Më 31 Dhjetor 2019 inventari i kolateraleve të marra prej 9,840 mijë Lek (31 Dhjetor 2018: 11,428 mijë Lek) I cili përfaqëson aktive marrë ne pronësi nga ekzekutimi I kolateralit të kredive me probleme. Vlerat e mësipërme paraqesin vlerë më të vogël më 31 Dhjetor dhe vlerën neto të realizueshme zvogëluar me koston e shitjes.

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Vlera bruto, Balanca hapëse	14,663	15,428
Shtesa	-	-
Pakësime	(197)	(568)
Vlera bruto, total	14,663	14,860
Fondi I zhvlerësimit, balanca hapëse	3,432	3,520
Shtesa	1,391	-
Pakësime	-	(88)
Fondi I Zhvlerësimit, Balanca mbyllëse	4,823	3,432
Vlera neto e aktiveve të rimarra	9,840	11,428

Gjatë vitit 2019 shoqëria ka rivlerësuar inventarin e kolateraleve nëpërmjet një vlerësuesi te pavarur, si rrjedhojë një provizion shtesë është krijuar nga zhvlerësimi i këtij inventari.

22. Hua

Shoqëria paguan interesat e principal dhe e shëtitës në përputhje me të gjitha marrëveshjet lidhur me huatë gjatë viteve dhe ne fund të 31 Dhjetor 2019 dhe 2018

	Normë mesatare e ponderuar e interesit	31 Dhjetor 19	Normë mesatare e ponderuar e interesit	31 Dhjetor 18
Normë fikse interesat				
EUR	4.87%	3,076,242	5.21%	2,199,729
LEK	5.31%	108,084	5.05%	382,937
Normë variabël interesat				
EUR	-	-	-	-
LEK	4.92%	1,023,198	6.73%	927,040
Interes i përllogaritur mbi huatë		37,072		33,647
Total		4,244,596		3,543,353
Afatshkurtër		1,599,525		1,807,715
Afatgjatë		2,607,999		1,701,992
Interes i përllogaritur mbi huatë		37,072		33,647
Total		4,244,596		3,543,353

Afati mesatar i kontratave të huave të Shoqërisë është 35 muaj. Më 31 Dhjetor 2019 vlera e mbetur e huave e garantuar me portofol të lënë peng në huadhenësit lokal është 440,766 mijë Lek (2018: 715,278 mijë Lek) dhe vlera e portofolit të lënë peng është 628,724 mijë Lek (2018: 928,861 mijë lek).

NOA SH.A.

Shënimë shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 (Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)

23. Obligacione

Më 16 dhjetor 2016, Këshilli i Administrimit aprovoi emetimin e obligacioneve afatmesme në monedhë vendase me normë interesë fiksë 7 %. Obligacionet janë të detajuara më poshtë në bazë të monedhës dhe datës së maturimit:

	Datë emetimi	Datë maturimi	Numër	31 Dhjetor 2019
Obligacione	1 Mars 2017	1 Mars 2020	160	80,000
Interesi i përllogaritur				1,867
Total			160	81,867

Interesi i përllogaritur me date 31 Dhjetor 2019 është 1,867 mijë Lek dhe maturohet në Mars 2020.

Shoqëria paguar ne kohe principalin dhe interesin si dhe ka qene ne përputhje me te gjitha kushtet e obligacionit gjatë vitit të mbyllur me 31 Dhjetor 2019 dhe 2018.

24. Grante

Më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 grantet janë të përbëra si më poshtë vijon:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
BFSE Holding B.V NFT grant	-	230
Të tjera	-	-
	-	230

Granti për NFT i referohet grantit të marrë nga BFSE Holdings B.V për zhvillimin e procesit të Teknologjisë për NOA-n. Shoqëria ka përfituar grantet e kushtëzuara të mësipërme të njohura si të ardhura të shtyra dhe të amortizuara gjatë jetës së dobishme të aktiveve përkatëse. Lëvizjet e granteve për vitin 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	2019	2018
	Lek '000	Lek '000
1 Janar	230	2,996
Shtesa	-	-
Amortizimi I vitit	(230)	(2,766)
Diferencia nga kursi i këmbimit		-
31 Dhjetor	-	230

25. Detyrime të tjera

Më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 detyrimet e tjera janë si më poshtë vijon:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Detyrime për qira (Shënumi 19)	126,657	-
Kosto për punonjësit dhe shpërblime të përllogaritura	14,800	16,700
Të pagueshme ndaj ofruesve të shërbimeve	13,800	19,572
Ceqe të lëshuara për t'u térhequr	4,974	19,341
Detyrime të tjera tatimore	13,158	11,876
Tarifa të tjera konsulence	2,600	1,501
Provigionë për çështje ligjore (25.1)	5,189	2,958
Të tjera	7,309	8,457
Total	188,487	80,405

25.1 Provigionë për çështjet ligjore:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Gjendja hapëse	2,958	2,480
Zvogëlime	(1,442)	(124)
Shtesa	3,673	602
Gjendja në mbyllje	5,189	2,958

Provigionet për çështjet ligjore përfshirë çështjet lidhur me ish stafin është 3,877 mijë Lek, klientë 214 mijë Lek, dhe palët e treta 1,096 mijë Lek.

NOA SH.A.

Shënimë shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 (Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)

26. Kapitali i paguar

Më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 totali i kapitalit aksionar i aprovuar i Shoqërisë përbëhet nga 73,183 aksione i cili është kapital i paguar me një vlerë nominale për aksion prej 10,000.12 Lek si më poshtë:

31 Dhjetor 2019

31 Dhjetor 2018

	Nr. Aksion e	Pronësia %	Mijë Lek	Nr. Aksione	Pronësia %	Mijë Lek
NOA Cooperatief U.A	1	0.001%	10	1	0.001%	10
NOA Holding N.V.	73,182	99.999%	731,829	73,182	99.999%	731,829
	73,183	100.0%	731,839	73,183	100.0%	731,839

Asambleja e përgjithshme vendosi më 17 Maj 2018 dhe 30 Korrik 2019 të paguajë respektivisht dividendë si më poshtë:

	2019	2018
NOA Holdings NV	65,864	69,889
NOA CooperatiefU.A	1	1
	65,865	69,890

Dividendët janë paguar plotësisht në Korrik 2019 dhe Maj 2018, përkatësisht

27. Rezerva ligjore

Dispozitat e Ligjit Tregtar kërkojnë krijimin e një rezerve prej 5% të ardhurave neto të Shoqërisë pas zbritjes së humbjeve të akumuluara nga vitet e mëparshme, derisa vlera e kësaj rezervë të arrije 10% të kapitalit aksionar të Shoqërisë.

28. Palët e lidhura

Gjatë zhvillimit të veprimtarisë së saj Shoqëria ka hyrë në transaksione të ndryshme biznesi me palët e lidhura. Palët e lidhura, duke përfshirë kompensimin për drejtuesit, me të cilat Shoqëria ka kryer transaksione biznesi janë si më poshtë:

	2019	2018
Detyrimet në fund të vitit		
Llogari të pagueshme për NOA Holding N.V	-	4,443
Grant BFSE Holding B.V	-	230
Transaksionet në fund të vitit		
Komisione për drejtimin për NOA Holdings N.V	5,215	5,392
Të drejta shfrytëzimi për NOA Holdings N.V.	3,133	3,235
Shpërblimi i drejtimit të lartë dhe Anëtarët e Bordit	62,733	39,234

BFSE Holding mban 51.67% të NOA Cooperatief U.A, aksioner i drejtpërdrejtë i NOA Holding NV.

Shpërblimi për drejtorët ekzekutivë dhe anëtarët e bordit përfaqëson shpërblimin e ekspit të lartë të menaxhimit dhe tarifat e menaxhimit të aplikueshme për anëtarët e bordit.

NOA SH.A.

Shënimë shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 (Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)

29. Analiza e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve

Tabela më poshtë paraqet një analizë të aktiveve dhe detyrimeve në bazë të pritshmërisë të shoqërisë për tu rimarrë ose mbyllur:

31 Dhjetor 2019	Deri ne 12 muaj	Mbi 12 muaj	Total
Aktive			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	327,691	-	327,691
Hua institucioneve financiare	540,659	-	540,659
Hua dhe paradhënie klientëve neto	2,092,124	2,613,754	4,705,878
Aktive të tjera	27,881	-	27,881
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe	-	166,320	166,320
Aktiv me të drejtë përdorimi	-	6,041	6,041
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	-	25,715	25,715
Aktiv tatimor I shtyrë	-	-	-
Total aktive	2,988,356	2,811,830	5,800,186

Detyrime

Grante	-	-	-
Tatim fitimi i pagueshmëm	11,096	-	11,096
Detyrime te tjera	61,829	-	61,829
Detyrime për qira	44,246	82,411	126,657
Obligacione të emetuara	1,867	80,000	81,867
Hua	1,636,597	2,607,999	4,244,596
Total Detyrime	1,755,635	2,770,410	4,526,045
Neto	1,232,721	41,420	1,274,141

31 Dhjetor 2018	Deri ne 12 muaj	Mbi 12 muaj	Total
Aktive			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	229,028	-	229,028
Hua institucioneve financiare	52,794	-	52,794
Hua dhe paradhënie klientëve neto	1,812,710	2,586,913	4,399,623
Aktive të tjera	23,773	11,428	35,201
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	-	31,242	31,242
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	-	9,836	9,836
Aktiv tatimor I shtyrë	-	27,362	27,362
Total aktive	2,118,305	2,666,781	4,785,086

Detyrime

Grante	230	-	230
Tatimfitimi I pagueshmëm	13,540	-	13,540
Detyrime të tjera	77,447	2,958	80,405
Obligacione të emetuara	1,867	80,000	81,867
Hua	1,594,522	1,948,832	3,543,354
Total detyrime	1,687,606	2,031,790	3,719,396
Neto	430,699	634,991	1,065,690

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)

30. Angazhime dhe detyrime të konstatuara

NOA ka lidhur disa marrëveshje huaje me bankat lokale ku huatë e marra janë siguruar duke vënë garanci portofolin e saj të arkëtueshme, balanca më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 është si më poshtë:

	2019	2018
Hua dhe paradhënie klientëve	628,724	929,861
Total	628,724	929,861

Procedura Ligjore

Shoqëria është përfshirë në disa procese gjyqësore dhe procedura ligjore të cilat rrjedhin nga aktiviteti i zakonshëm i biznesit. Bazuar në këshillat e brendshme apo të jashtme ligjore, drejtimi mendon se këto procese nuk do të kenë efekt të rëndësishëm në pozicionin financier dhe aktivitetin e Shoqërisë.

31. Ngjarje pas datës së raportimit

Përhapja e koronavirusit në vitin 2020 ndikon ndjeshëm në aktivitetin e NOA. Pasojat e mundshme të koronavirusit dhe masat qeveritare kanë pasoja te klientët tanë, bazuar në vlerësimet tona 29% e klientëve janë prekur drejtpërdrejt pasi biznesi ose vendi i tyre i punës është mbyllur nga qeveria. Më 17 Mars 2020, Banka e Shqipërisë dhe Qeveria bashkë-nënskruan dhe rikonfirmuan shtyrjen e kësteve të kredive për bizneset e prekura.

Më 24 Mars 2020 u shpall Situata Kombëtare e Fatkeqësive Natyrore (Situata më e lartë e Emergjencës) nga Shteti Shqiptar. Më tej, u shpall lista e bizneseve që nuk lejohen dhe që lejohen të vazhdojnë aktivitetin, për më tepër bare, restorante, ushqim i shpejtë etj.

Më 2 Prill 2020 Shteti Shqiptar u kërkoi të gjithë pronarëve që të shtyjnë pagesat e qirasë për biznesin e prekur pas muajit Maj 2020.

Përhapja e koronavirusit ndikon në mënyrë të konsiderueshme në cilësinë e portofolit të kredisë dhe likuiditetin e NOA sha. Klientët kryesorë të prekur nga përhapja e koronavirusit ishin hotelet, restorantet, baret; industria përpunuese (me përjashtim të produkteve ushqimore), shërbime të tjera, tregtia e mallrave (me përjashtim të produkteve ushqimore), të cilat në Maj 2020 ishin PAR1+ duke arritur në 15% të portofolit bruto të kredisë dhe PAR 30 në 5%. Shoqëria ka riskeduluar 23% të portofolit bruto të kredive si rezultat i COVID 19.

Kufizimet e koronavirusit kanë çuar në:

- Rënien e kërkeshës për produkte dhe /ose shërbime që ka ndikuar drejtpërdrejt në dhënien e kredive.
- Uljen e pagesave të kredisë, të ndikuar nga masat e Qeverisë kundrejt COVID 19 për hotelet, restorantet, baret, industritë përpunuese (me përjashtim të produkteve ushqimore), shërbimet e tjera, tregtinë e mallrave (me përjashtim të produkteve ushqimore), të cilat përfaqësojnë 29% të portofolit tonë bruto.
- Uljen e detyrueshme të orarit të punës për të ruajtur sigurinë e stafit;

Përveç këtyre, janë marrë masat e mëposhtme:

- Janë ofruar shërbime online për aplikim kredie.
- Për klientët të cilët kanë aplikuar për riskedulim janë përdorur mjete dixhitale për të përfunduar të gjithë procesin pa asnjë kontakt fizik.
- Janë nënskruar marrëveshje me Shoqëritë e shërbimit të pagesave për të siguruar që klientët tanë të kenë më shumë kanale alternative për të bërë pagesat përfshirë pagesat elektronike.

NOA SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 *(Shumat në mijë Lek, perveçse kur shprehet ndryshe)*

31. Ngjarje pas datës së raportimit (vazhdim)

Për shkak të shtyrtjes së kësteve të klientëve, për të mbajtur pozicionin e likuiditetit të Shoqërisë në një nivel të pranueshëm në të ardhmen, janë marrë masat e mëposhtme:

- Është ulur niveli I disbursimit në nivelin e ripagesave nga klientët;
- U rishikuani të gjitha shpenzimet operative dhe u pezulluan të gjitha shpenzimet që nuk dëmtojnë aktivitetin e biznesit (marketing, udhëtime, transport, trajnime, shërbime të tjera),

Rrjeti po punon me kapacitet të plotë prej fillimit të muajit Maj 2020. Zyra qëndrore ka punuar me kohë të plotë, me rotacion stafi në mënyrë që të respektohen rregullat e distancimit social.

- U nisen negociatat me te gjithë huadhënësit për rinoimin e kësteve të tremujorit të 2-të dhe të tretë të 2020 dhe ne kemi qenë në kontakt me të gjithë partnerët tanë në mënyrë që të sigurohen përditësimet më të fundit të performancës financiare të NOA dhe gjithashtu strategjia e financimit afatmesëm.
- U monitorua likuiditeti afatshkurtër i Shoqërisë duke përdorur një model parashikues bazuar në historikun e Shoqërisë për 6 javët e ardhshme.

Këto pasiguri pritet të kenë një ndikim të madh në aktivitetet e biznesit tonë, në rezultatet dhe fondet tonë; u rishiku perspektiva për 12 muaj dhe u projektua një ulje prej 5% në rritjen e portofolit dhe 30% në përfitueshmëri kundrejt buxhetit.

Drejtimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin potencial dhe do të marrë të gjitha masat e duhura dhe hapat e mundshëm për të ulur ndikimin negativ. Drejtimi e konsideron përhapjen e COVID-19 si një ngjarje pasuese jo rregulluese.